

**AKT THEMELIMI**  
**I SHOQËRISË TREGTARE ME OFERTË PRIVATE**  
**“ADRIATICA ENERGY” SHA**

Shoqëria tregtare “ADRIATICA ENERGY” SHA , me aksionar themelues:

- **WEYBRIDGE ASSET RECOVERY shpk**, e themeluar si person juridik sipas Ligjit Tregtar Shqiptar ne fuqi, më datë 21.10.2021,ne QKB me NIPT M12221006P, me seli Njesia Administrative Petrele, Fshati Mullet, Rr.Sh3, Rezidenca Olive Grove, Nd.A2/3, Tirane, Perfaqesuar per nenshkrim nga Z. Ahmet Gjinishi & Znj. Ioana Ghitea

Aksionarët në cilësinë e organit vendimmarrës të shoqërisë, sot me date 14 Dhjetor 2022 miratojnë këtë Akt Themelim të Shoqërisë Tregtare “ADRIATICA ENERGY” SHA, me përmbajtjen si më poshtë:

**KREU I**  
**EMRI, FORMA LIGJORE, THEMELUESIT, SELIA, OBJEKTI DHE KOHËZGJATJA**

**NENI 1**  
**EMRI**

1. Emri i shoqërisë është “ADRIATICA ENERGY” SHA.
2. Emri i shoqërisë do të ndiqet nga prapashtesa “SHA”, e cila përcakton formën e organizimit si shoqëri aksionare.
3. Emri tregtar i cili do të përdoret nga shoqëria do të jetë;  
" ADRIATICA ENERGY " dhe “ADRIATICA PETROLEUM”

**NENI 2**  
**FORMA LIGJORE**

1. Shoqëria është një shoqëri aksionare me ofertë private.
2. Shoqëria vepron në përputhje me këtë statut dhe legjislacionin shqiptar në fuqi.
3. Shoqëria mund të shndërrohet në një formë tjetër në përputhje me parashikimet e nenit 228 dhe vijues të Ligjit Nr. 9901 datë 14.04.2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare”.

**NENI 3**  
**AKSIONARËT THEMELUES**

1. Shoqëria është themeluar prej Aksionarëve;
- **WEYBRIDGE ASSET RECOVERY shpk**, e themeluar si person juridik sipas Ligjit Tregtar Shqiptar ne fuqi, më datë 21.10.2021,ne QKB me NIPT M12221006P, me seli



Njesia Administrative Petrele, Fshati Mullet, Rr.Sh3, Rezidenca Olive Grove, Nd.A2/3, Tirane, Perfaqesuar per nenshkrim nga Z. Ahmet Gjinishi & Znj. Ioana Ghitea

#### NENI 4

#### SELIA

1. Shoqëria ka selinë e saj në adresën:  
**Njesia Administrative Nr.10, Rruga e Kavajes, Nd.1, H.11 Ap.2, Tirane.**
2. Aksionarët e shoqërisë mund ta ndryshojë lirisht adresën e Selisë së shoqërisë.

#### NENI 5

#### OBJEKTI I VEPRIMTARISË

##### 1. Objekti veprimtarisë së shoqërisë është:

1- Menaxhimin dhe ofrimi i shërbimeve operacionale për nxjerrjen e produkteve, transportin, ruajtjen, përpunimin, nxjerrjen e nënprodukteve, tregtimin, zgjerimin e tregut, partneritetet, bashkëpunimet, kontratat e bashkëpunimit, kontratat e shitjes ose investimit, kontratat e aseteve dhe kontratat e borxhit dhe krediti. Këshilla për bordin e drejtorëve të kompanisë, menaxhimin e aseteve, pronës intelektuale, markës tregtare dhe patentës së Adriatica Petroleum Refinery. Kontraktimi dhe ndërmjetësimi i shitjeve me pakice dhe shumice, ne tregjet vendase apo te huaja. Menaxhimin e politikës së jashtme dhe planet e investimeve afatgjate.

2- Importim, eksportim, tranzitim dhe tregtim me shumicë e pakicë të benzinës, naftës, gazit, gazoilit, vajgurit, benzolit, solvenit, ksilol solvenit, vaj-spirit, lëndëve djegëse solar, mazut, gaz të lëngëzuar, bitum, asfalt dhe lubrifikantët e të gjitha llojeve dhe natyrave, si dhe të gjithë produkteve dhe nënprodukteve hidrokarbure të këtyre natyrave dhe llojeve, si dhe përpunimi i tyre.

3- Ndërtimin e të gjithë objekteve në lidhje me përpunimin e mbetjeve vajore e hidrokarbure. Të përfitojë drejtpërdrejtë nga përpunimi i tyre, të kontraktojë të tjerë apo të punojë me nënkontraktues. Të menaxhojë impiante (fabrika, manifaktura) për përpunimin e mbetjeve të përfitojë ekonomikisht nga ndërtimi i këtyre objekteve brenda kuadrit ligjor për përpunimin e cdo lloj nafte. Veprimtari në fushën e naftës. Mbledhjen e vajrave dhe të mbetjeve të tjera hidrokarbure, si dhe pastrimin e mbetjeve nga anijet.

4- Blerja, marrja me qira, dhënja me qira e pikave te shitjes me pakicë të karburantit. Marrja me qira ose blerja e anijeve në lidhje me grumbullimin e mbetjeve nga anijet. Përfitimi nga fondet nderkombetar mbi pastrimin dhe trajtimin e mbetjeve. Përmirësimi i puseve të naftës dhe kryerja e punimeve për veprimtarinë e tyre. Marrja me qira e tokave brenda dhe jashtëvendit për nxjerrje, përpunim dhe trajtim te hidrokarburëve. Blerja e know-how në lidhje me këto punime. Pastrimi i tubave të naftës dhe kimike branda apo jashtëvendit dhe të gjitha veprimtaritë në lidhje me këtë çështje.



5- Perfitoje, transferoje, te marre apo jape me qera, te bleje dhe shese, si dhe te kontraktoje, te drejten e markes, patentes, licences, dhe te drejttat e tjera qe jane te ngjashme me keto.

## NENI 6

### KOHËZGJATJA E VEPRIMTARISË

1. Kohëzgjatja e veprimtarisë së Shoqërisë është për një afat të pacaktuar.

## KREU II

### KAPITALI DHE AKSIONET

## NENI 7

### KAPITALI DHE AKSIONET

1. Kapitali i shoqërisë është 3,500,000 (tre milion e pesëqind mijë) Lekë.
2. Kapitali është i ndarë në 3,500 (tre mijë e pesëqind) aksione të zakonshme me vlerë nominale 1,000 (një mijë) Lekë secili.
3. Kapitali është i ndarë aksione ku aksionari WEYBRIDGE ASSET RECOVERY shpk zotëron 100 (një qind) % të aksioneve në vlerë monetare 3,500,000 (tre milion e pesëqind mijë) lekë
4. Me depozitim bankar është derdhur 1.000.000 (një milion) leke vlere e kapitalit te shoqerise. Pjesa e mbetur do te depozitohet jo me vone se 31 Mars 2023

## KREU III

### ORGANIZIMI I SHOQËRISË

## NENI 8

### ORGANET DREJTUESE TË SHOQËRISË

1. Organet e shoqërisë janë:
  - a) Aksionarët e shoqërisë, në cilësinë e organit vendimmarrës për shoqërinë;
  - b) Këshilli Administrimit;
  - c) Administratori i shoqërisë.
2. Aksionarët kanë të drejtë të caktojnë dhe ose/krijojnë, bazuar në propozimin e Këshillit të Administrimit dhe/ose Administratorit/Administratorëve, organe/struktura teknike brenda shoqërisë.



## NENI 9

### ASAMBLEJA E AKSIONARËVE NË CILËSINË E ORGANIT VENDIMMARRËS

1. Asambleja e Aksionarëve, është organi më i lartë vendimmarrës i shoqërisë.
2. Asambleja e Aksionarëve ushtron kompetencat/çështje të tjera të parashikuara shprehimisht nga ligji apo statuti (NENI 11 Pika 2).
3. Asambleja e Përgjithshme, për çështjet parashikuara në shkronjën (e) dhe (f), do të vendosë pasi të ketë marrë dokumentacionin përkatës së bashku me raportin e Këshillit të Administrimit dhe ekspertit kontabël.

## NENI 10

### ANËTARËT E KËSHILLIT TE ADMINISTRIMIT

- a) **Znj. IOANA GHITEA**, e datelindjes 11.01.1982, lindur ne Oradea / Rumani, banuese ne Njesia Administrative Petrele, Fshati Mullet, Rr.Sh3, Rezidenca Olive Grove, Nd.A2/3, Tirane, shtetase rumune, leje banimi shqiptar 253385 nr. leternjoftim 838064393, mbajtese e pasaportes me nr. 057973295, madhore, me zotesi te plote juridike per te vepruar;
- b) **Z. RIAD GHARIANI**, shtetas amerikan, i datelindjes 07.10.1967, lindur në Libi dhe banues në 1034 Tirane, pajisur me leje qendrimi 254518 nr leternjoftim 838211222, mbajtës i pasaportes Nr. 531264401, madhor dhe me zotësi të plotë juridike për të vepruar;
- c) **Z. AHMET GJINISHI**, shtetas shqiptar, i datelindjes 02.02.1980, lindur ne Peqin dhe banues ne 1004 Tirane. Leternjoftim nr 035172211 dhe nr personal H80202025Q, madhor dhe me zotësi të plotë juridike për të vepruar;

1. Mandati i anëtarëve të Këshillit i Administrimit është 3 (tre) vjet me të drejtë rizgjedhjeje
  1. **RIAD GHARIANI** (*Kryetar*)
  2. **IOANA GHITEA** (*Anëtar*)
  3. **AHMET GJINISHI** (*Anëtar*)

## NENI 11

### ADMINISTRATORI

1. Shoqëria administrohet nga 1 (një) administrator me mandat 3 (tre) vjeçar. Administratori caktohet/emërohet nga Këshilli i Administrimit, në përputhje me dispozitat e statutit dhe ligjit shqiptar “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare”.
2. Këshilli i Administrimit mund të emërojë më shumë se një administrator.
3. Në rast se shoqëria do të ketë më shumë se një administrator, Këshilli i Administrimit ka të drejtë të caktojë një nga administratorët e shoqërisë si Administrator të Përgjithshëm.



4. Administratori i Përgjithshëm ka të drejtë të kryejë i vetëm të gjitha kompetencat që ky statut dhe ligji shqiptar “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare”, ia njeh administratorit të një shoqërie aksionare.

#### NENI 12

#### ADMINISTRATOR I SHOQËRISË

1. **Z. Ahmet GJINISHI**, shqiptar, mbajtës i Letërnjoftimit Nr.035172211 do të jetë në cilësinë e Administratorit të Përgjithshëm të kësaj shoqërie, me një mandat 3 (tre) vjeçar.
2. Administratori ka të drejtën e rizgjedhjes.

#### KREU IV

#### NENI 13

#### VITI FINANCIAR

1. Viti Financiar i Shoqërisë fillon më 1 Janar dhe mbaron më 31 Dhjetor të çdo viti.

#### NENI 14

#### EKSPERTI KONTABËL I REGJISTRUAR

1. Asambleja e Aksionarëve emëron ekspert kontabël të regjistruar. Ekspertët Kontabël të Regjistruar kanë të drejtën e riemërimit. Ekspertë Kontabël i Regjistruar i Shoqërisë, për një afat 3 –vjeçar, me të drejtë riemërimi, caktohet:

- Ekspert Kontabel / Auditues Ligjor **BERTI PASHKO** i datelindjes 22.01.1963 nr personal **G30122082K** Letërnjoftim nr **034440974** dhe **Shoqeria Audituese HOLLY AND ENDI AUDITING**, themeluar ne Tirane, me 01.03.1999, adrese Blv. At Gjergj Fishta, Pll E88, No.12, Tirane, NIPT Nr. **K31323006D**, Perfaqesuar nga Berti Pashko

#### NENI 15

#### PASQYRAT FINANCIARE DHE KONTABILITETI

1. Pasqyrat financiare vjetore, përfshirë bilancin, dhe deklaratat do të përgatiten sipas legjislacionit shqiptar.
2. Në rast se legjislacioni i mësipërm e lejon, Administratori i shoqërisë mund të zgjedhë midis standardeve të ndryshme të kontabilitetit.



## NENI 16

### SHPËRNDARJA E DIVIDENDIT

1. Shoqëria do të deklarojë dhe shpërndajë tek Aksionarët e saj si dividend, të gjithë fitimin e disponueshëm, pasi të jenë përmbushur të gjitha kërkesat ligjore dhe të rezervave të njohura nga legjislacioni në fuqi, si dhe pasi të jetë respektuar çdo marrëveshje tjetër mes aksionarëve mbi ripagesën e shumave të kredituar ose e investimeve të bëra në emër të shoqërisë.
2. Aksionarët përpara se të vendosin për shpërndarjen e dividendit duhet të vlerësojnë interesin më të mirë të Shoqërisë, duke marrë në konsideratë gjendjen financiare të saj.

## KREU V DISPOZITA TË FUNDIT

### NENI 17 LIGJI I ZBATUESHËM


1. Shoqëria do të zhvillojë aktivitetin e saj në përputhje të plotë me këtë dhe Statut dhe me ligjin shqiptar. Për sa nuk është parashikuar në këtë akt, do të zbatohen dispozitat e legjislacionit shqiptar në fushën e shoqërive tregtare.

## NENI 18

1. Ky Statut përpilohet në 2 (dy) kopje origjinale, secili me të njëjtën vlerë ligjore. Njëri prej tyre ruhet në dokumentacionin bazë të shoqërisë

### AKSIONARËT THEMELUES TË SHOQËRISË “ADRIATICA ENERGY” SHA

WEYBRIDGE ASSET RECOVERY shpk

JOANA CHITRA  


Armet Gjimesh  
